

# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTIJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,  
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#125

## Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së, znj. Sonila Hysi takim me drejtoreshën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Znj. Zana Çela



Me drejtoreshën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, Znj. Zana Çela, mbi bashkëpunimin e mëtejshëm dhe të frytshëm të artistëve shqiptarë në Shqipëri dhe atyre në diasporë.

Znj. Çela me vizionin dhe punën e palodhur ka qenë gjithmonë një mbështetje për Agjencinë Kombëtare të Diasporës në fushën e bashkëpunimit artistik dhe kulturor.

Znj. Hysi, drejtore ekzekutive në Agjencinë Kombëtare të Diasporës solli në vëmendje rëndësinë që ka përcjellja e artit dhe kulturës sonë pranë komuniteteve shqiptare në diasporë, ndërkohë që Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, si një pasuri e trashëgimisë artistike dhe kulturore ka qenë dhe do të jetë gjithnjë prezent në diasporën shqiptare.

Për AKD dhe TKOB bashkëpunimi është jo vetëm një detyrë institucionale por edhe një mision i çmuar që përcjell artin dhe kulturën tonë tek shqiptarët kudo në botë.



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## Nënskruhet Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Bashkisë së Tiranës

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi falenderoi Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj dhe nënkryetaren, znj. Anuela Ristani për nënskrimin e këtij memorandumi i cili do të shërbejë diasporës shqiptare, veçanërisht rinisë shqiptare në diasporë për angazhimin dhe përfshirjen e tyre në vendin e origjinës.


Nëpërmjet këtij memorandumi këto dy institucione do të bashkëpunojnë për nxitjen e organizimeve, aktiviteteve të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, promovimin e pjesëtarëve të diasporës në fushën e artit, kulturës, përfshirjen e të rinjve në projekte dedikuara inovacionit (ICT) e më gjerë, si dhe në nxitjen e vijimësisë së konsultimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor dhe Agjencisë për çështje të lidhura me diasporën.



## Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

## New York / Marshim për të kërkuar drejtësi për viktimat e luftës në Kosovë



Në datën 28 tetor para Konsullatës së Serbisë në Nju Jork, do të organizohet marshimi për të kërkuar drejtësi për viktimat e luftës në Kosovë, Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë.

Marshi është iniciativë e këshilltarit të bashkisë së New Yorkut, dhe njëkohësisht kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Mark Gjonaj.



## CONNECT ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Qendra e Botimeve për Diasporën boton online falas "Mësojmë Shqip, Fletore Tematike, Niveli A1-A2"

QBD boton online falas "Mësojmë Shqip, Fletore Tematike, Niveli A1-A2", tekstin më të ri didaktik për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë, hartuar nga Dr. Maklena Çabej dhe Prof. As. Dr. Rozana Rushiti. Ky tekst i hartuar në harmoni me programin e kurrikulës së përbashkët të miratuar nga Ministritë e Arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës, merr parasysh specifikat e nxënësve prej të cilëve do të përdoret dhe vjen në kuadër të "Mëso shqip", një paketë e dobishme e cilësore didaktike, e cila përmban 8 tekste didaktike ku përfshihen librat e mësuesit dhe materiale të tjera plotësuese. Materialet letrare të përzgjedhura në këto tekste e ndihmojnë nxënësin të ndërmarrë një rrugëtim letrar nëpër temat e mëdha të botës shqiptare, siç janë ato të vendlindjes e atdheut, të gjuhës amtare, të vetëdijes identitare, të trashëgimisë kulturore e gjuhësore etj.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë



## Diaspora Shqiptare

Aplikacioni Gazeta  
"Diaspora Shqiptare"

SHKARKO  
APLIKACIONIN FALAS

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen